



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:091803

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100643

C.nr.402/23

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në çështjen juridike civile të paditësit H. Z, mësimdhënës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Savrovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. B. K nga Prizreni, ndaj të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria Komunale e Arsimit, përfaqësuar nga A. B, me objekt kontesti për kompensim për të shujtave ditore me vlerë të kontestit të pa përcaktuar, me dt. 29.08.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor

- I. APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditësit H. Z, mësimdhënës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Savrovë.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve në emër të kompensimit të shujtave ditore t’ia paguaj për 145 ditë pune shumë prej **290 €**, për periudhën **2022 deri me dt. 21.11.2022**, me kamatë ligjore 8% nga data e parashtrimit të padisë 19.04.2023 e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej **98€**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi H. Z, mësimdhënës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Savrovë, pranë kësaj Gjykate me datë 19.04.2023, përmes të autorizuarit av. B. K, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit për pagesën e shujtave ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

E paditura përgjigje në padi nuk ka dhënë.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit, **është e bazuar**.

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të*

kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

I autorizuari i paditësit, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shujtave ditore, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi në vërtetimin me nr. 25/II të dt. 20.02.2023 të lëshuar nga Institucioni shkollor SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Savrovë, u vërtetuan ditët e punës së paditësit për kompensimin e shujtave ditore.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësve gjen mbështetje të plotë në nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive, të lidhur më 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parasheh: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare të institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.*

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që kanë prezantuar paditësit, konkretisht vërtetimeve të lëshuara nga Drejtoritë e shkollave, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë shumën prej 78 € dhe shumën prej 20 € në emër të taksës gjyqësore apo në shumë të përgjithshme prej 98 €.

Gjykata aktgjykimin e ka marr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr. 402/23 dt.29.08.2024**

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.